



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

Në përputhje me nenin 1 paragrafi 1.3 pika (ç) të Rregullores nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Duke pasur parasysh dispozitat e akteve nënligjore për vendosjen e rezidentëve në institucionet e përkujdesjes sociale, Me qëllim të përmbushjes së nevojave personale të rezidentëve, Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 04/2007
PËR
RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR PËRKRAHJEN FINANCIARE
TË REZIDENTËVE TË STREHUAR NË SHTËPITË E PERSONAVE PËR
PËRKUJDESJE SOCIALE**

Neni 1

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat e përkrahjes financiare për përmbushjen e nevojave personale të rezidentëve të strehuar në Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë dhe atyre në Institutin Special të Shtimes.

Neni 2

Lartësia e shumës së mjeteve të përkrahjes financiare (në formë të parave të xhepit) për përmbushjen e nevojave personale për një rezident është dhjetë (10) €për një muaj.

Neni 3

Lartësia e shumës së përkrahjes financiare për rezidentët mund të ndryshojë, varësisht nga mundësitë buxhetore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe si e tillë mund të shfrytëzohet nga rezidentët për përmbushjen e nevojave të ndryshme personale.

Neni 4

Zyrtarët përgjegjës të DMS-së të MPMS-së, duhet të parashikojnë dhe përllëgojnë mjetet financiare për këto destinacione në fund të vitit për vitin pasardhës, me rastin e përcaktimit të buxhetit vjetor për institucionet e përkujdesjes sociale.

Neni 5

Rezidentët mbi moshën 65 vjeç të cilët janë shfrytëzues të pensionit bazë, apo të ndonjë të drejte dhe beneficioni tjetër eventual, e kanë të drejtën e përkrahjes financiare mujore në lartësi prej 10 €

Neni 6

Për të gjithë rezidentët të cilët për shkaqe shëndetësore nuk mund të menaxhojnë me paratë e xhepit, stafi menaxhues i SHPMPPF-së dhe i JSSH-së, do të formojë një komision të veçantë i cili do t'i mbajë dhe menaxhojë këto mjete financiare. Komisioni do të shpenzojë mjetet financiare në përbushjen e nevojave të këtyre rezidentëve, varësisht nga dëshirat dhe nevojat e tyre.

Për shpenzimet dhe menaxhimin e këtyre mjeteve financiare, komisioni në fjalë është i obliguar të raportojë në formë të shkruar çdo tre muaj te drejtori i institucionit.

Neni 7

Rezidentët të cilët për shkaqe shëndetësore nuk mund të menaxhojnë me paratë e pensioneve bazë dhe me mjetet e përkrahjes financiare, drejtori i Institucionit (SHPMPF) në bashkëpunim me QPS-në përkatëse e caktojnë kujdestarin ligjor sipas procedurës ligjore për mbajtjen dhe menaxhimin e këtyre mjeteve financiare.

Neni 8

Kujdestari ligjor autorizohet në formë të shkruar nga drejtori i institucionit (SHPMPF), lidhur me obligimet që i merr përsipër për menaxhimin e mjeteve financiare të rezidentit dhe i shpenzon ato sipas nevojave të këtij rezidenti.

Neni 9

Kujdestari në bashkëpunim me nëpunësin e shërbimeve sociale të Institucionit lidhur me, nevojat e klientit si dhe për shpenzimet e parave, e informon në formë të shkruar drejtorin e institucionit në fund të çdo muaji.

Neni 10

Me rastin e vdekjes eventuale të rezidentit, të mirat materiale dhe mjetet financiare të mbetura në dhomën e klientit pas vdekjes së tij, duhet t'i pranojë një komision i formuar enkas për këtë qëllim nga stafi punonjës i institucionit.

Të gjitha të mirat materiale apo mjetet financiare pas vdekjes së rezidentit i dorëzohen familjes së tij. Nëse nuk ka familje atëherë ato shfrytëzohen në të mirë të rezidentëve të Institucionit.

Neni 11

Kjo formë e përkrahjes financiare do të aplikohet deri sa nuk gjendet ndonjë formë tjetër e mbështetjes.

Neni 12

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa do të aplikohet nga 01.01.2007.

Prishtinë, shkurt 2007

Ministri i MPMS-së
Ibrahim Selmanaj
